R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2889/1 prot. Tiranë, më 19.10.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin "Për masat përgatitore dhe shoqëruese për pjesëmarrjen e ardhshme të Republikës së Shqipërisë në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI)"

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj me nr. 7444 prot., datë 24.09.2026, nëpërmjet së cilës përcillni për mendim projektvendimin "Për masat përgatitore dhe shoqëruese për pjesëmarrjen e ardhshme të Republikës së Shqipërisë në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI)", së bashku me relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit rezulton se parashikohet ngritja e kuadrit institucional, organizativ dhe procedural për përgatitjen e institucioneve shqiptare për përdorimin e ardhshëm të sistemit IMI, një platformë elektronike e Bashkimit Evropian, që mundëson shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin administrativ ndërmjet autoriteteve kompetente.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se në projektvendim janë parashikuar garancitë kryesore për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht lidhur me përgjegjësitë e autoriteteve kompetente, respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, konfidencialitetin, si dhe ruajtjen e fshirjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Rregulloren (BE) nr.1024/2012.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë se gjatë fazës përgatitore, sipas nenit 6 të projektvendimit, parashikohet mbajtja dhe administrimi i regjistrit që përfshin të dhëna personale të personave institucionalë të kontaktit, vlerësojmë të nevojshme disa saktësime lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e këtyre të dhënave.

Referuar ***shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 6 të projektvendimit***, sugjerojmë të qartësohen kategoritë e të dhënave personale që do të përfshihen në regjistrin e personave institucionalë të kontaktit, si dhe të përcaktohen kufizimet e aksesit dhe masat për garantimin e sigurisë së tyre, në përputhje me parimin e minimizimit të të dhënave dhe kërkesat e neneve 6 dhe 28 të ligjit nr. 124/2024.

Për sa më sipër, sugjerojmë që në nenin 6 të projektvendimit të shtohet një pikë, me këtë përmbajtje: *"Regjistri i personave institucionalë të kontaktit përmban vetëm të dhënat personale të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të tij. Aksesi në këto të dhëna u lejohet vetëm personave të autorizuar, duke garantuar zbatimin e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë dhe konfidencialitetin e tyre."*

Gjithashtu, referuar ***pikës 1 të nenit 9 të projektvendimit***, e cila parashikon përditësimin e të dhënave të personave institucionalë të kontaktit, vlerësojmë të nevojshme përcaktimin e afateve të ruajtjes së këtyre të dhënave ose të kritereve për përcaktimin e tyre, si dhe të procedurave për fshirjen e të dhënave që nuk janë më të nevojshme për qëllimin e përpunimit, në përputhje me parimin e kufizimit të ruajtjes, të parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 124/2024.

Për sa më sipër, sugjerojmë që në nenin 9 të projektvendimit të shtohet një pikë, me këtë përmbajtje: *"Të dhënat personale të personave institucionalë të kontaktit ruhen për aq kohë sa janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimit të përpunimit dhe fshihen kur nuk ekziston më një nevojë e ligjshme për ruajtjen e tyre, veçanërisht në rastet kur personat përkatës nuk ushtrojnë më funksionet për të cilat janë caktuar."*

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se me reflektimin e sugjerimeve të mësipërme projektvendimi është në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi